



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
MINISTRI

Nr. 1735 Prot.

Tiranë, më 14.04 2022

URDHËR

Nr. 244, Datë 14.04 2022

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR TREGTIMIN ME SHUMICË APO  
PAKICË TË PAJISJEVE MJEKËSORE NËPËRMJET INTERNETIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 28 të Ligjit Nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe nenit 24, pika 3 të Ligjit 89/2014 "Për Pajisjet Mjekësore" të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Tregimi me shumicë i pajisjeve mjekësore nëpërmjet internetit, kryhet nga tregtuesit me shumicë, të cilët janë persona juridikë të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet, dhe në zbatim të kritereve të vendosura në këtë urdhër.
2. Tregimi me pakicë i pajisjeve mjekësore nëpërmjet internetit, kryhet nga tregtuesit me pakicë, të cilët janë persona fizikë dhe juridikë të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet, dhe në zbatim të kritereve të vendosura në këtë urdhër.
3. Lejohet tregimi i pajisjeve mjekësore nëpërmjet internetit për përdoruesit joprofesionistë vetëm për klasën I dhe IIa dhe pajisjet mjekësore të destinuara për mbrojtje kundër përhapjes së sëmundjeve ngjitëse, nëse ato mund të përdoren në mënyrë të sigurt.
4. Lejohet tregimi i pajisjeve mjekësore nëpërmjet internetit për të gjitha klasat vetëm për përdoruesit profesionistë, sipas legjislacionit në fuqi.
5. Të gjithë pajisjet mjekësore që do të tregtohen nëpërmjet internetit duhet të janë të pajisura me markimin CE ose certifikimin FDA, si dhe duhet të janë të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi.
6. Faqja e internetit duhet të jetë një strukturë e licencuar nga organi përgjegjës AKEP dhe të përbajë të dhënat e mëposhtme:
  - a) të dhëna të plota mbi adresën dhe identitetin ligjor të shitësit;
  - b) objektin e veprimtarisë "tregtim me shumicë apo pakicë të pajisjeve mjekësore";
  - c) listën e pajisjeve mjekësore;



- c) listën e pajisjeve mjekësore;
  - d) fotografi të pajisjes, përshkrimin e pajisjes dhe udhëzime mbi përdorimin e pajisjes.
7. Tregtuesit me shumicë apo pakicë të pajisjeve mjekësore para fillimit të tregtimit të pajisjeve mjekësore nëpërmjet internetit duhet të njoftojnë Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore nëpërmjet postës elektronike në adresën [akpbm@shendetesia.gov.al](mailto:akpbm@shendetesia.gov.al) Njoftimi duhet të përbajë informacionin si vijon:
- a) Listën e pajisjeve mjekësore që do të tregtohen nëpërmjet internetit me të dhënat si vijon:
    - i. modelin e pajisjes;
    - ii. prodhuesin;
    - iii. numrin e certifikatës së regjistrimit.
  - b) Faqen e internetit që subjekti do të përdorë për tregtimin e pajisjeve mjekësore të çertifikuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.
  - c) Emrin dhe adresën e ambjenteve për magazinim dhe ruajtje të pajisjeve mjekësore të regjistruar në QKB dhe të licensuar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë.
8. Pajisjet mjekësore që do të tregtohen nëpërmjet internetit duhet të jenë të etiketuara dhe pajisura me fletëudhëzuesin e përdorimit në gjuhën shqipe. Ky informacion duhet të jetë gjithmonë i disponueshëm dhe lehtësisht i aksesueshëm në platformën elektronike ku kryhen veprimet e marketimit dhe shitblerjes së pajisjes mjekësore.
9. Tregtuesi me shumicë apo pakicë të pajisjeve mjekësore duhet të tregtojë pajisjet mjekësore vetëm në paketimin origjinal të prodhuesit.
10. Tregtuesi me shumicë apo pakicë i pajisjeve mjekësore duhet të ruajë në një regjistër të veçantë të gjithë shitjet e pajisjeve mjekësore të kryera nëpërmjet internetit. Regjistri i shitjeve të pajisjeve mjekësore të kryera nëpërmjet internetit është subjekt kontrolli nga institucionet përgjegjëse për inspektim, sipas legjisacionit në fuqi.
11. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, struktura përgjegjëse për pajisjet mjekësore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe subjektet që do të ushtrojnë veprimitarinë e tregtimit me shumicë apo pakicë të pajisjeve mjekësore nëpërmjet internetit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.



